

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 23.12.2021

Më datë 23 Dhjetor u zhvillua mbledhja e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i:

1. Relacionit dhe projekt-vendimit për klasifikimin ISCED 2011;
2. Relacionit dhe projekt-vendimi për klasifikimin NPA 2.1;
3. Planit të aktiviteteve për vitin 2022;
4. Ecurisë së Klasifikimit Ndërkombëtar të Krimeve, ICCS.

Në mbledhjen online ishin prezent 17 anëtarë të KKN dhe bordi i drejtorëve të INSTAT.

Duhet theksuar që anëtarët e KKN janë njohur më parë me përmbajtjen e relacioneve dhe projekt-vendimeve për klasifikimet.

Takimi u hap nga Kryetarja e KKN, Znj. Elsa Dhuli. Pas miratimit të axhendës nga të gjithë anëtarët, mbledhja vijoi sipas rendit të ditës.

Znj. Dhuli prezantoi përmbajtjen e projekt-vendimeve për klasifikimet ISCED 2011 dhe NPA 2.1, ku theksoi që të dy klasifikimet janë në përputhshmëri të plotë me klasifikimet evropiane (NPA 2.1) dhe ndërkombëtare (ISCED 2011). Më tej fjalën e mori Z. Maldi Dema ku prezantoi fillimisht relacionin e ISCED 2011.

Projekt-vendimi dhe relacioni dhe për klasifikimin ISCED 2011 u miratua në parim nga anëtarët e KKN.

Takimi vijoi me diskutimet mbi klasifikimin e produkteve. Z. Maldi Dema prezantoi relacionin e NPA 2.1.

Znj. Alketa Tari bëri komente lidhur me teknikën legjislative bazuar në manualin e hartimit të ligjeve të Shqipëri

Z. Maldi Dema shprehu dakordësinë me sugjerimet e znj. Alketa Tari.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Projekt-vendimi dhe relacioni dhe për klasifikimin NPA 2.1 u miratua në parim nga anëtarët e KKN.

Kryetare i KKN, Znj. Elsa Dhuli prezantoi planin e aktiviteteve të KKN për vitin 2022, ku vuri theksin mbi kërkesat që institucionet kanë përsa i përket trajnimeve. INSTAT cdo vit përgatit që plan trajnimesh me qëllim ngritjen e kapaciteteve të përdoruesve të statistikave zyrtare.

Në takimin e parë për vitin 2022 të KKN, plani i trajnimeve do të finalizohet, bazuar edhe në nevojat e anëtarëve të KKN.

Më tej diskutimi vijoi me prezantimin nga Znj. Majlinda Nesturi, Drejtor i Drejtorisë së Statistika Sociale pranë INSTAT, mbi aktivitetet e zhvilluara dhe aktivitetet në proces lidhur me hartëzimin e kapitujve të Klasifikimit Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistikore (ICCS).

ICCS klasifikon veprat penale bazuar në koncepte, përkufizime dhe parime të pranuara ndërkombëtarisht për të rritur konsistencën dhe krahasueshmërinë kombëtare dhe ndërkombëtare të statistikave. Klasifikimi është ndërtuar në mënyrë që ngjarjet, aktet dhe veprat e përfshira të konsistojnë në vepra penale dhe jo administrative, si dhe duhet të përfshijë të gjithë veprat penale. Grupi i punës ka dakortësuar dhe finalizuar 8 nivelet e para të ICCS. Hartëzimi i niveleve 9, 10 dhe 11 u diskutuan me grupin e punës gjatë workshopit të fundit dhe pritet të përfundojë brenda muajit Dhjetor 2021.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al